

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Frontier Group, me seli të regjistruar në Le Grelelej 5, 2600 Antverp, Belgjikë, përmes Shoqërisë së Avokatëve Çoku dhe Partnerëve nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 16.06.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Frontier Group, me seli të regjistruar në Le Grelelej 5, 2600 Antverp, Belgjikë, do të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë Ferranti Computer Systems, me seli të regjistruar në Romeinsvel 7, 2030 Antverp, Belgjikë, përmes shitblerjes së pjesëve të, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë takse administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 denarë, si dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra dhe programi i të hyrave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin vijues: Ligji), më datë 21.05.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin vijues: Komisioni) është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Frontier Group, me seli të regjistruar në Le Grelelej 5, 2600 Antverp, Belgjikë, me të cilin Frontier Group do të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë Ferranti Computer Systems, me seli të regjistruar në Romeinsvel 7, 2030 Antverp, Belgjikë.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimi të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Veprimtaritë themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Frontier Group është një shoqëri e sapo themeluar e varur, në pronësi të plotë të Main Capital VIII Coöperatief U.A., fond i menaxhuar nga Main Capital Partners, shoqëri e kapitalit privat e cila kryen aktivitete investuese dhe menaxhuese të orientuara drejt ndërmarrjeve në fushën e softuerit afarist dhe shërbimeve të IT-së në Evropë dhe SHBA, duke përfshirë blerjen, zhvillimin strategjik dhe mbikëqyrjen e shoqërive të portofolit përmes fondeve të rregulluara investuese. Main Capital vepron ekskluzivisht si investitor i kapitalit privat, ndërsa menaxhimi lokal i veprimtarisë afariste, nëse është i zbatueshëm, kryhet nga vetë shoqëritë e portofolit. Main Capital nuk ka investime të drejtpërdrejta në shoqëri portofoli në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe, sipas njohurive të tij më të mira, nuk ka as investime të tërthorta në subjekte juridike maqedonase përmes më shumë se 60 shoqërive të portofolit në nivel global. Në përputhje me këtë, Main Capital nuk realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe as nuk kryen shitje në tregun maqedonas.

Ferranti, anëtare e Nijkerk Group që nga viti 1994, është themeluar në vitin 1976 në Antverp, Belgjikë. Ferranti ushtron veprimtari në nivel global në fushën e transformimit digjital, inxhinierisë së softuerit, instalimeve elektrike në impiante industriale dhe tregtisë me shumicë të pajisjeve të teknologjisë informative dhe komunikuese. Produkti kryesor i Ferranti është MECOMS 365, platformë e integruar për aplikacione afariste, e dedikuar për shoqëritë energjetike dhe shoqëritë nga sektori komunal në nivel global, e cila përfshin proceset si vijon: menaxhimi i përvojës së klientit (qasje omnikanale dhe vetëshërbim); sistemi për menaxhimin e të dhënave të klientëve (kontrata dhe faturim); menaxhimi i të dhënave nga pajisjet matëse (matje inteligjente dhe manuale); shërbimet në terren (menaxhimi i aseteve/pajisjeve); financat dhe operacionet (menaxhimi i funksionimit afarist).

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Ferranti ka një shoqëri të varur në pronësi të plotë – Shoqëria për shërbime nga fusha e teknologjisë informative MEKOMS SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. „Maqedonia“ nr. 11A, Shkup – Qendër, me numër amë 7359624 dhe veprimtari të regjistruar kryesore 62.100 – Programim kompjuterik. MEKOMS SHPKNJP Shkup të ardhurat e përgjithshme i realizon përmes faturimit ndaj shoqërisë së saj amë.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ